# REPUBLIKA E SHQIPERISË
# AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

## UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A

# DOKUMENTAT STANDARDE TË PROCEDURËS SË HAPUR SHËRBIME

### E HAPUR- MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR

**“Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”**

## I . NJOFTIMI I KONTRATËS

**Seksioni 1.Autoriteti Kontraktor**

**1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri Ujesjelles Kanalizime Tirane sh.a.

Adresa Rruga“’Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027,Tiranë.

Tel/Fax 00 355 42240978

E-mail info@ukt.al

Faqja e Internetit www.ukt.al

Personi Përgjegjës: A.Q

Email : alma.quku@ukt.al

**1.2 Lloji i autoritetit kontraktor:**

| | |
|---|---|
| Institucion qëndror | Institucion i pavarur |
| ☐ | ☐ |
| Njësie qeverisjes vendore | Tjetër |
| ☐ | **X** |

**1.3 Kontratë në kuadrin e një Marrëveshjeje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe një Shteti tjetër**

Po ☐ Jo ☐

**Seksioni 2 Objekti i kontratës**

**2.1.Numri i referencës së procedurës/lotit REF-84067-01-14-2021**

**2.2 Lloji i “Kontratave Publike për Shërbime”**

| Konkurs Projektimi | Shërbime Konsulence | Shërbime të tjera |
|---|---|---|
| ☐ | ☐ | **X** |

**2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër**

Po  Jo  **X**

## 2.4 Lloji i Marrëveshjes Kuadër

**Me një Operator Ekonomik** ☐

**Me disa operatorë ekonomikë**

**Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po** ☐ **Jo**

**Në Marrëveshjen Kuadër me 1 Operator Ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, të jepen arsyet e përzgjedhjes së kësaj lloj Marrëveshje Kuadër**

| |
|---|
| |

**2.5 Numri i operatorëve ekonomikë me të cilët do të perfundojë Marrëveshja Kuadër: (*Këtu duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër*).**

| | | |
|---|---|---|
| **2.6** | Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike | |

## 2.8 Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër

1.Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës 999.800.000( nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e tetëqind mijë) lekë pa tvsh.

-Vlera e zbatimit të objektit është 484.948.781( katërqind e tetëdhjetë e katër milion e nëntëqind e dyzetë e tetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

-Vlera e monitorimit dhe e mirëmbajtjes të sistemit të sigurisë për 36 muaj nga data e kolaudimit të objektit për 199 objekte është 514.851.219 (pesëqind e katërmbëdhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e një mijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa tvsh.

***Sqarim: Bëjmë me dije se në mbështetje të Rekomandimit Nr.6911, datë 28.10.2020 " vlerat e ofertës ekonomike të investimit dhe të monitorimit e mirëmbajtjes të ofruar nga operatorët ekonomikë nuk duhet të tejkalojnë vlerën e fondit limit të parashikuar në njoftimin e kontratës për këto zëra, pasi në të kundërt oferta do të konsiderohet si ofertë e dhënë mbi fond limit.***

***Tejkalimi i fondit limit përbën kusht për skualifikim.***

2.Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është ________**

3.Burimi i Financimit" : Fonde të akorduara nga Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a sipas projektbuxhetit nr.prot 18016/2, datë 29.10.2020.

Financimi për procedurën e sipërcituar në projektbuxhetin e mësipërm është parashikuar dhe do të realizohet për 3 vite përkatësisht 2021, 2022, 2023.

4.Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër "**Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike"**

**2. 9 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:**

Kohëzgjatja : Afati për kryerjen e punimeve do të jetë 6 muaj nga data e lidhjes të kontratës.
Afati i monitorimit dhe mirëmbajtjes të sistemit të sigurisë për 199 objekte është 36 muaj nga data e kolaudimit të objektit.

2.9.1 Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër

| |
|---|
| **Kohëzgjatja në muaj:** *ose* **ditë: (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër***(jo më shumë se (4) vjet***)** |
| *Ose* **duke filluar nga // (dd/mm/vvvv)**<br>**Përfunduar më // (dd/mm/vvvv)** |

**2.10 Vendi i kryerjes së shërbimeve, objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: Sipas vendodhjes të objekteve.**

________________________________________________________________

________________________________________________________________

**2.11 Ndarja në Lote:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Po | | Jo | **X** |

*Nëse po,*

**2.12 Përshkrim i shkurtër i loteve**

(Objekti  dhe fondi limit i
loteve)1________________________________________________________________
______2.______________________________________________________________
______3.______________________________________________________________
______etj.

Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot], [disa lote], [të gjitha lotet]. Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë.

**2.13 Opsionet:**

Numri i rinovimeve të mundshme *(nëse ka)*:

Ose: nga në

**2.14 Do të pranohen variantet:**

| Po | | Jo | |
|---|---|---|---|

**2.14.1Do të pranohet nenkontraktimi:**

| Po | | Jo | |
|---|---|---|---|

**Nese do te lejohet nenkontraktimi,** te specifikohet perqindja e lejuar per nenkontraktim: ____

Autoriteti kontraktor do t’i beje pagesa te drejperdrejte nenkontraktorit:

| Po | | Jo | |
|---|---|---|---|

**Shenime te tjera**

______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________

**2.15. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standartet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqerisë së Informacionit:**

| Po | | Jo | |
|---|---|---|---|

**2.16. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standardet janë të pa-aplikueshme, është marrë miratimi**

**“Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”**

**paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Po | | Jo | |

**Seksioni 3**<u>**Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik**</u>

**3.1 Kriteret e Pranimit <u>sipas Shtojcës 8</u>**

**3.2 Sigurimi i Ofertës: (** i zbatueshëm në rastin eprocedurave të prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, në rast se kërkohet nga autoriteti kontraktor**)** Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, **sipas Shtojcës 3**. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është _________ Lekë (shuma e shprehur në fjalë).

Në rastet e dorëzimit të ofertës për Lote, vlera e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, për secilin nga Lotet është si më poshtë:
Loti 1 ______ Lekë
Loti 2 ______ Lekë

**Seksioni 4**<u>**Procedura**</u>

**4.1 Lloji i procedurës:**E hapur

Procedurë prokurimi e rishpallur

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Po** | | **JO** | **X** |

Nëse është procedurë e rishpallur të plotësohen të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a)Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së prokurimit të anulluar

b) Objekti i prokurimit të procedurës së prokurimi të anulluar ”

c)Fondi limit i procedurës së prokurimit të anulluar

**4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**
A) **çmimi më i ulët X**
*Ose*
B) **oferta ekonomikisht më e favorshme**
lidhur me rëndësinë: Çmimi **pikë**
etj.
Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.

**4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

**Data: 02.03.2021 (dd/mm/vvvv) Ora:10:00**
**Vendi:app.gov.al**

**Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, ëëë.app.gov.al**

**4.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

**Data: 02.03.2021 (dd/mm/vvvv) Ora:10:00**
Vendi: app.gov.al

**Informacioni mbi ofertate paraqitura me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.**

**4.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave:** 150 *(e shprehur në ditë)*

**4.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Shqip | **X** | Anglisht **X** | |
| Tjetër | ____________ | | |

**Seksioni 5 Informacione plotësuese**

**5.1 Dokumenta me pagesë (i zbatueshëm vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Po | | Jo | |

*Nëse Po*

| | | | |
|---|---|---|---|
| Monedha | ________ | Çmimi | ______ |

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DT tek Operatorët Ekonomikë. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DT para blerjes së tyre.

**5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit)**

**“Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”**

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi **15.01.2021**

**“Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”**

**Njoftimi i kontrates për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor, i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike**

**1.Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri Ujesjelles Kanalizime Tirane sh.a.
Adresa Rruga“’Rruga e Kavajës,Ndërtesa nr.133,Njësia Administrative 6,Kodi Postar 1027,Tiranë

Tel/Fax 00 355 42240978
E-mail info@ukt.al
Faqja e Internetit www.ukt.al

**2. Lloji i procedurës se prokurimit: Shërbime- E hapur mbi kufirin e lartë monetar.**

**3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër “Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”**

**4. Numri i referencës së procedurës/lotit REF-84067-01-14-2021**

**5. Fondi limit** 999.800.000( nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e tetëqind mijë) lekë pa tvsh.

-Vlera e zbatimit të objektit është 484.948.781( katërqind e tetëdhjetë e katër milion e nëntëqind e dyzetë e tetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

Vlera e monitorimit dhe e mirëmbajtjes të sistemit të sigurisë për 36 muaj nga data e kolaudimit të objektit për 199 objekte është 514.851.219 (pesëqind e katërmbëdhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e një mijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë) lekë pa tvsh.

**6.Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:** Afati për kryerjen e punimeve do të jetë 6 muaj nga data e lidhjes të kontratës.

Afati i monitorimit dhe mirëmbajtjes të sistemit të sigurisë për 199 objekte është 36 muaj nga data e kolaudimit të objektit.

***Sqarim**: Në bazë të udhëzimit të përbashkët datë 30.12.2020 nr.prot 25366 dhe nr.prot 8480 midis Agjencisë të Prokurimit Publik si dhe Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve ju informojmë se për nënshkrimin e një kontrate publike në përfundim të proçedurës të prokurimit operatori ekonomik duhet të ketë:*

***-Kopje të çertifikatës elektronike për fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin platformën qëndrore të Faturave.***

**“Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”**

***- Kopje të çertifikatës elektronike për fiskalizimin dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me shoqërinë e çertifikuar për zgjidhjen softëerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes softëerike.***

**7- Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:** 02.03.2021, ora 10:00

**8- Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:** 02.03.2021, ora 10:00

## II. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË

### Seksioni 1. Hartimi i ofertës

1.1 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.

1.2 Operatori Ekonomik përballon kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Autoriteti Kontraktor nuk është përgjegjës për këto kosto.

1.3 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertesduhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me iniciale ose të nënshkruhen nga Personi (-at) e autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i firmosur nga Personat e Autorizuar.

1.4 Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomikë, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së prokurimit.

1.5 Operatori ekonomik, mban përgjegjësi për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës. Në rast verifikimi të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, apo të vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton e vërtetë, operatori ekonomik ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 13, pika 3, gërma (a) të LPP-së.

1.6 **Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:**

a) Formulari i Ofertës Ekonomike, plotësuar sipas Shtojcës 1 të DT.

b) Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 1/1.

c) Dokumentat që lidhen me objektin e prokurimit (*skica, katalogje, kampione etj*)
___________ ,
___________ ,
___________ .

ç) Dokumentat dhe vërtetimet e kërkuara në Shtojcën 7.

d) (Opsion) ofertën alternative teknike (nëse parashikohet)

Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

Me plotesimin e Shtojcës “Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së Dispozitave Ligjore në Marrëdhëniet e Punës„„ operatori ekonomik pranon se ka kontrata pune me çdo punëmarrës dhe që respekton të drejtat e punëmarrësve, sipas dispozitave të Kodit të Punës (ku përfshihen edhe të drejtat e gruas shtatzënë, gruas që sapo ka lindur dhe/ose gruas me fëmijë në gji, të parashikuara në nenet 104, 105, 105/a, 106, 108 dhe 115, dhe të legjislacionin të punës në tërësi.

1.7Fshehtësia e procesit sipas nenit25 të LPP-së.

1.8 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të dorëzojnë vetëm ofertën origjinale të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: “Ofertë për kryerjen e __________shërbimeve; Nr e Njoftimit _______________
**“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA ___________ (dd/mm/vv) orës ______”.**

**Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, ëëë.app.gov.al.**

1.9 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose të tërheqin ofertat e tyre, me kusht që ky modifikim ose tërheqje të kryhet para afatit kohor përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet, ashtu edhe tërheqjet duhet t’i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim para datës së fundit për dorëzimin e ofertave. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet përkatësisht: **“MODIFIKIM OFERTE”** ose **“TËRHEQJE OFERTE”.**

**Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike,ofertuesi mund te modifikojë në çdo kohë ofertën deri përpara përfundimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave, pa patur nevojë për ndonjë komunikim me autoritetin kontraktor, pasi veprimet kryhen në llogarinë e tij, në faqen zyrtare të APP-së, ëëë.app.gov.al.**

**Seksioni 2 Përllogaritja e ofertës ekonomike**

2.1 Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar shërbimet që do të ekzekutohen dhe çmimin e tyre.

2.2 Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH. Nëse çmimet kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

2.3 Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës Ekonomike, çmimet totale të ofertës të të gjitha Shërbimeve, pa TVSH. Vlera e TVSH, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës.

2.4. Në rastin e nje marrëveshje kuadër ku të gjitha kushtet NUK janë përcaktuar, çmimet për kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk janë të fiksuara; ato janë objekt i ndryshimit pas një mini-konkurrimi midis operatorëve ekonomikë, palë në marreveshjen kuadër.

2.5 Sigurimi i Ofertës, kur kërkohet, duhet të dorëzohet bashkë me ofertën para skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Mospajtimi me kërkesat për sigurimin e ofertës do të ketë si pasojë refuzimin e ofertës.

2.6 Sigurimi i Ofertës, kur kërkohet, mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:

a) garanci bankare
b) garanci sigurimi

Formulari i sigurimit të ofertës duhet të nënshkruhet nga lëshuesi (Banka, kompania e sigurimit, etj) dhe duhet të dorëzohet së bashku me ofertën para hapjes së ofertave, përndryshe oferta do të refuzohet.

Dokumentat si më sipër duhet të jenë të vlefshëm përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Në rastin kur sigurimi i ofertës ka formën e një garancie bankare, Autoriteti Kontraktor ia rikthen ofertuesve sigurimin përkatës brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

2.7 **Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës**

Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, *të paktën 5 ditë nga përpara* përfundimit të afatit kohor për vlefshëmrinë e ofertave, autoriteti kontraktor mund t’i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund t’a refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton Autoritetin Kontraktor me shkrim, dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti Kontraktor do të refuzojë ofertën.

**2.8** Veprimet e jashtëligjshme sipas Nenit 26 të LPP-së

**Seksioni 3. <u>Vlerësimi i ofertave</u>**

**3.1 Kriteret e përzgjedhjes**

**(Opsioni 1)** Çmimi më i ulët i ofertës së kualifikuar.

Kontrata do t’i akordohet atij Ofertuesi që ka ofruar çmimin më ulët të ofertës.

**(Opsioni 2)** Oferta ekonomikisht më e favorshme.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter dmth sa pikë do të ketë çdo kriterdhe si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën do të llogariten pikët e ofertuesve në këtë rast është:

Po= Pk1+Pk2+Pk3+.....

Ku:
Po - jane pikët totale të ofertës së vlerësuar
Pk1/Pk2/Pk3/... - jane pikët për çdo kriter të vlerësuar

Pikët për çdo kriter përllogariten sipas formulës:

Pk1= Vmink1 x Pmaxk1/Ok1

| | |
|---|---|
| Pk1 _____ | Pikët e kriterit që vlerësohet |
| Vmin k1 | Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet |
| Pmaxk1 | Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet |
| Ok1 | Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet |

**Sqarim**
Si kriter vlerësimi duhet të përzgjidhet vetëm njëri prej opsioneve. Plotësimi i të dy opsioneve e bën procedurën të pavlefshme.

Në rastin e prokurimit të marrëveshjes kuadër, kur objekt i kësaj marrëveshje janë biletat e transportit ajror ndërkombëtar, në vend të çmimit do të përdoret marzhi i fitimit i shprehur në përqindje.

## 3.2 Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra

3.2.1 Autoriteti Kontraktor korrigjon ato gabime në ofertë, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti Kontraktor e njofton menjëherë Ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim/elektronik mbi çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që Ofertuesi t’a ketë miratuar këtë komunikim që i është bërë. Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë.

3.2.2 Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga Autoriteti Kontraktor, si mëposhtë:

- në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shuma në fjalë lidhet me një gabim aritmetik;

- nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korrigjohet shuma në total, nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojë nëntotali dhe totali duhet të korrigjohet. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet*Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se ± 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.*

## 3.3 Ofertat anomalisht të ulëta

3.3.1 Nëse oferta e dorëzuar, rezulton anomalisht e ulët në lidhje me shërbimet e ofruara, atëherë Autoriteti Kontraktor i kërkon Ofertuesit në fjalë të justifikojë çmimin e ofruar. Nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim që të bindë Autoritetin Kontraktor, atëherë ky i fundit ka të drejtë të refuzojë ofertën.

3.3.2 Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët sipas përcaktimit të bërë në nenin 66 të Kreut VIItë RrPP .

Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25 përqind e fondit limit të përllogaritur.

Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85 përqind e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP.

Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe dokumentojë me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementët e veçantë të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Formula që do të zbatohet për të cilësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ka tre ose më shumë oferta të vlefshme është si më poshtë:

O – Oferta
$M_O$ – Mesatarja e Ofertave të vlefshme
n – Numri i Ofertave të vlefshme
$Z_M$ – Zbritja e Mundshme

$$M_O = O_1 + O_2 + O_3 + \ldots O_n / n$$

$$Z_M = 85\ \%\ Mo$$

**Vlera e Ofertës që vlerësohet <ZM.......... , <u>si rrjedhim Oferta është Anomalisht e Ulët</u>**

Në rastin kur kriter vlerësimi është përzgjedhur oferta ekonomikisht më e favorshme, do të verifikohet nëse ofertat janë anomalisht të ulëta vetëm nëse oferta e klasifikuar me pikët më të larta e ka ofertën ekonomike me vlerën më të ulët.

3.3.3 Ankimi administrativ në dispozicion të Operatorëve Ekonomikë sipas nenit 63 të LPP-së.

## Seksioni 4. <u>Nënshkrimi i kontratës</u>

### 4.1 Njoftimi i fituesit

Autoriteti Kontraktor njofton Ofertuesin fitues, përmes dërgimit të njoftimit të fituesit, siç parashikohet në **Shtojcën 14.** Një kopje e këtij njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, siç kërkohet në Nenin 58 të LPP-së.

### 4.2 Sigurimi i kontratës

4.2.1 Autoriteti Kontraktor kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës. Shuma e sigurimit për ekzekutimin e kontratës do të jetë 10 % e vlerës së kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, sipas **Shtojcës 20 të DT**, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës.

4.2.2 Sigurimi për ekzekutimin e kontratës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:

- garanci bankare,
- garanci sigurimi,

**Ky formular nuk përdoret nga autoritetet kontraktore në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale.**

### 4.3 Njoftimi i kontratës së nënshkruar

Në pajtim me RrPP, pas nënshkrimit të kontratës, autoriteti kontraktor dërgon një njoftim në APP për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

**Shënim**: Autoritetet kontraktore nuk duhet të ndërhyjnë për të bërë asnjë lloj ndryshimi në dokumentat e tenderit nga pika 1 në pikën 4.

## III. SHTOJCAT

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e DT:

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike
Shtojca 1/1: Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur
Shtojca 2: Formulari i Ftesës për Ofertë (në rastin e Marrëveshjes Kuadër)
Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës
Shtojca 4: Formulari i Informacionit Konfidencial
Shtojca 5: Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike dhe të Termave të Referencës nga operatori ekonomik
Shtojca 6: Deklaratë për konfliktin e interesit
Shtojca 7: Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve te pergjithshme
Shtojca 7/1: Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës
Shtojca 8: Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes
Shtojca 9: Specifikimet teknike
Shtojca 10: Planifikimi i kontratave në marrëveshjen kuadër
Shtojca 11: Sherbimet dhe Grafiku i ekzekutimit
Shtojca 12: Termat e Referencës
Shtojca 13. Formulari për Njoftimin e Skualifikimit
Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Fituesit
Shtojca 15:Formulari i Njoftimit te operatorëve ekonomikë të suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër
Shtojca 16: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
Shtojca 17: Kushtet e Veçanta të Kontratës
Shtojca 18: Formulari i Njoftimittë Kontratës së Nënshkruar
Shtojca 19: Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike
Shtojca 20: Formulari i Sigurimit të Kontratës
Shtojca 21: Formulari i Ankesës në Autoritetin Kontraktor
Shtojca 22: Draft Marrëveshja Kuadër ku Jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara
Shtojca 23: Draft Marrëveshja Kuadër ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara
Shtojca 24: Formulari i Njoftimit të Anullimit

**“Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”**

**Shtojca 1**

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik*]

## FORMULARI I OFERTËSEKONOMIKE

Emri i Ofertuesit_____________________

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se*

- * * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- Çmimi total i ofertës sonë është [*monedha dhe vlera e ofertës*]; pa TVSH;
- Çmimi total i ofertës sonë është [*monedha dhe vlera e ofertës*]; me TVSH

| Nr | Nr. Analizë | Përshkrimi i Punëve | Njësi | Sasia | Çmimi/ Njësi | Cmimi total |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1.Zbatimi i projektit të sistemit të sigurisë** | | | | | | |
| **Shuma** | | | | | | |
| **Fondi Rezervë** | | | | | | |
| **Shuma 1** | | | | | | |
| **2.Monitorim dhe mirembajtje te sistemeve te sigurise** | | | | **199 objekte** | | |
| **Shuma 2** | | | | | | |
| **Totali pa TVSH (shuma 1 + shuma 2)** | | | | | | |
| **TVSH (shuma 1 + shuma 2)** | | | | | | |
| **SHUMA TOTAL (shuma 1 + shuma 2)** | | | | | | |

**“Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”**

Nënshkrimi i ofertuesit ______________

Vula ______________

Shënim:
Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____( e kerkuar ne dokumentat e tender

***Sqarim: Bëjmë me dije se në mbështetje të Rekomandimit Nr.6911, datë 28.10.2020 ” vlerat e ofertës ekonomike të investimit dhe të monitorimit e mirëmbajtjes të ofruar nga operatorët ekonomikë nuk duhet të tejkalojnë vlerën e fondit limit të parashikuar në njoftimin e kontratës për këto zëra, pasi në të kundërt oferta do të konsiderohet si ofertë e dhënë mbi fond limit.***

***Tejkalimi i fondit limit përbën kusht për skualifikim.***

**Shtojca 1/1**

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË**

**Për paraqitje Oferte të Pavarur**

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë:_________________; nga Autoriteti Kontraktor: __________________; me objekt: ______________________; me fond limit: __________________.

Unë i nënshkruari _____________________, me cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik__________________, në mbështetje të nenit 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklarim dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

Unë vërtetoj, në interes të:___________________________që:
(Emri i operatorit ekonomik)

- Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
- Unë kuptoj që oferta e paraqitur do tës’kualifikohetdhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nukështëe plotëdhe / ose e saktënëçdo aspekt;
- Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi tëfirmos këtëDeklaratë dhe të paraqes ofertë nëinteres të Ofertuesit;
- Çdo person, firma e të cilit shfaqet nëdokumentacionin e ofertës,ështëi autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruarofertën nëinteres të Ofertuesit;
- Për qëllim tëkësajdeklarate dhe ofertëssë paraqitur,unë kuptoj që fjala “konkurrentë”nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, tëndryshëm ngaOfertuesi,të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik,që:
  - paraqesin njëofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratësdhe/ose tëFtesës për Ofertë,të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
  -ështënjëofertues potencial, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojënjëofertënëpërgjigje, të Njoftimit të Kontratësdhe/ose tëFtesës për Ofertë.
- Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

- Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;

- Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

- Nëveçanti,pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), tëpërmendur më lart,nuk ka pasur konsultime,komunikime,kontratëapo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

  - çmimet ;
  - metodat,faktorët ose formulat e përdorurapër llogaritjen e çmimit;
  - qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
  - paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës përofertë.

- Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime,komunikime,marrëveshjeapo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë,sasinë,specifikimet apo dërgesa tëveçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit tëmësipërm 6. b).

- Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohurame qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, nëçdo mënyrëqoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave,shpalljes fitues dhelidhjes së kontratës,vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

__________________________________________________
(Emri dhe Firma e Personit të Autorizuar për Përfaqësim të Ofertuesit)

________________ ____________________
(Titulli sipas pozicionit në punë) (Data)

**Shtojca 2**

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor në Marrëveshjen Kuadër gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*]

**FTESA PËR OFERTË**

(*shkruani emrin e Autoritetit Kontraktor*)
fton për të paraqitur oferta në procedurën për kryerjen e shërbimeve të mëposhtme:
…………………………………………………………………………………………………
…………………………………………………………………………………………………
…………………………………………………………………………………………………
(*jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratës dhe sasise siç përkufizohet në Dokumentat e Tenderit (DT).*

<u>Vendi i kryerjes së shërbimit</u>
*(jepni një përshkrim të shkurtër)*

Kohëzgjatja e shërbimit ______________________

Oferta duhet të paraqitet
…………………………………………………………………………………………………
[*Jep adresën e saktë*]
Përpara
………………………………………………………………………………………………
[*Përcaktoni datën dhe orën përfundimtare*]

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

Forma e komunikimit:

Me shkrim __ Elektronik ( email, fax etj.) _____

**Shtojca 3**

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]
[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik kur kërkohet nga autoriteti kontraktor*]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

*[Data]*

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-se*

- * * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë[emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra]* si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar nëdokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës ose ftesën për tender*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimi

**Shtojca 4**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti*]

## LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

| Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial | Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial | Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**KUJDES**

Çdo e dhënë, që nuk është regjstruar si e dhënë konfidenciale, do të konsiderohet se titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës dhe Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për publikimin e këtij informacioni.

Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.

**Shtojca 5**

**“Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

## DEKLARATË MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE REALIZIMIN E OBJEKTIT SIPAS GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë _________________ nga Autoriteti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Unë i nënshkruari _______________,me cilësinë e ________ të personit juridik _______________deklaroj se:

Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë, si dhe marrim përsipër realizimin e objektit sipas grafikut të ekzekutimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës ________________

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

V ula

**Shtojca 6**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË**
**Mbi konfliktin e interesave**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë __________________ nga Autoriteti Kontraktor_________________ me objekt _____________ me fond limit ___________.

Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat,Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët  në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

  Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtj ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

**“Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”**

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari ____________________, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _______________deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** te Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës ________________

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

____________________________

**Vula**

**“Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”**

**Shtojca 7**

**[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]**

**DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesemarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë_______________ nga Autoriteti Kontraktor ___________ me objekt ___________________me fond limit __________.

Unë i nënshkruari __________________me cilesinë ___________të operatorit ekonomik ___________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik ______________________ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

- Operatori ekonomik ____________________ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.

- Personi/at në cilësinë e ***anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik,***si më poshtë:
  _____________________
  _____________________
  _____________________etj.
  nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP.

- Operatori ekonomik ____________________ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

- Operatori ekonomik ____________________ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

- Operatori ekonomik ____________________ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës _____________**

**Nënshkrimi i ofertuesit ______________**

**Vula _____________**

**Shtojca 7/1**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në proçedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _______________ nga Autoriteti Kontraktor ___________ me objekt _______________me fond limit __________.

Unë i nënshkruari __________________me cilësinë e ___________të operatorit ekonomik __________________, **<u>deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:</u>**

- Operatori ekonomik ________________________garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.

- Operatori ekonomik___________________lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.

- Operatori ekonomik ________________nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Nërastet kur janë konstatuar shkelje ligjore,operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

**Data e dorëzimit të deklaratës _____________**
**Përfaqësuesi i ofertuesit**
**Nënshkrimi**
**Vula**

**Shtojca 8**

[ *Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

## 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë,duhet te dorezohen:**

**a.**Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

**b.** Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formulari i Ofertës, sipas Shtojces 1;*
*b. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1*
*c. Sigurimi i ofertes, në vlerën 2% të fondit limit sipas Shtojcës 3;*
*ç.Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
*d.Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;*
*dh.Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 7/1;*
*e.Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

3.Kandidati/ofertuesi duhet tëdorëzojë:

**3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

3.1.1 Referuar **kritereve te përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1** e dokumentave standarte te tenderit te cilat mbeshteten në nenin 46, të Ligjit Nr. 9643, datë 20/11/2006, “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe vërtetojnë se operatorët ekonomikë kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës.

3.1.2 Operatori ekonomik duhet të paraqese Licencë për ushtrimin e aktivitetit të ruajtjes dhe sigurimit fizik të objekteve publike dhe privatenë kategorinë ”1.3.A” konform Ligjit Nr.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”.

3.1.3 Operatori ekonomik duhet të paraqese Licencë të drejtuesit teknik për ushtrimin e aktivitetit të ruajtjes dhe sigurimit fizik të objekteve publike dhe private në kategorinë ”1.3.A, konform Ligjit Nr.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”.

**3.5 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Vlerësimi i gjëndjes ekonomike dhe financiare të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtëm.

**3.6**.Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të 3 viteve (2017, 2018, 2019) të paraqitur pranë autoritetit përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet, si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar ne rastin kur shoqeria ofertuese eshte subjekt që në përputhje me aktet ligjore në fuqi duhet të kryejë akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar.

**3.7.** Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të (2017, 2018, 2019) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogël se 30% e vlerës së fondit limit perkatesisht: 299.940.000 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e dyzetë mijë) lekë pa tvsh.

**3.8**.Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.*

3.9.Operatorët ekonomik pjesmarrës nuk duhet të rezultojnë debitorë pranë Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a (Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën e verifikimit mbi çdo operator ekonomik pjesmarrës). Në rast se operatorët ekonomik pjesmarrës rezultojnë debitorë ndaj UKT sh.a përbën kusht skualifikimi.

**3.9 Kapaciteti teknik:**

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë 3 viteve të fundit (nga data e zhvillimit të tenderit) me një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet ose 299.940.000 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e dyzetë mijë) lekë pa tvsh.

- Kur shërbimi i ngjashëm i mëparshëm është realizuar me institucione shtetërore,Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate.

- Kur shërbimi i mëparshëm i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë sherbim duke paraqitur faturat përkatëse tatimore ku të jetë shënuar datat shuma , të nënshkruar nga të dyja palët.

3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë liçensën profesionale si më poshtë vijon:

- **Kategoria NP-1 A***(Punime gërmimi në tokë)*
- **Kategoria NP3 B(** Rikostruksion dhe mirëmbajtje)
- **Kategoria NS-4 B** *(Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, ...)* **–**
- **Kategoria NS-14 C (***Impjante te brendshme, elektronike, telefoni,radio telefoni, TV* **) –**

sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI;

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t’i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

3.5.Operatori ekonomik duhet të zotërojë Licencë/Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit dhe radioalarmit të lëshuar nga AKEP konform ligjit Nr. 9918 datë

19/05/2008 ”Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” me zonë mbulimi sipas objekteve ku kerkohet sherbimi ne Qarkun e Tiranës. Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik duhet të paraqesë liçensë/ autorizim të lëshuar nga AKEP.

3.6. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë qendër kontrolli në Qarkun Tiranë, kategoria 1.3.A. Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të mësipërm duhet të paraqesë Akt-Miratimin të lëshuar nga DPV, Tiranë.

3.7.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë jo më parë se viti 2020, kategoria 1.3.A, konform ligjit nr.75/2014 dhe akteve nënligjore në fuqi për funksionimin e shërbimin privat të sigurisë fizike përmes të cilit të provohet që operatori ekonomik disponon:

- Jo më pak se 45 punonjës shërbimi, nga të cilët:
- Përgjegjës shërbimi 4 punonjës të kategorisë 1.3.A.
- Operator salle kontrolli 5 punonjës të kategorisë 1.3.A.
- Për verifikimin e sinjaleve të alarmit 10 grupe të kategorisë 1.3.A .

3.8.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

| **Nr.** | **Përshkrimi i Automjetit/ Pajisjes** | **Në pronesi /me qera** | **Sasia/ copë** |
|---|---|---|---|
| **1.** | Autoveture | Në pronësi/ ose me qera | **10** |
| **2.** | Motorra | Në pronësi/ ose me qera | **6** |
| **3.** | Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 ton | Në pronësi/ ose me qera | **5** |
| **4** | Kamion me Vinç | Në pronësi/ ose me qera | **2** |
| **5** | Betoniere | Në pronësi/ ose me qera | **4** |
| **8.** | Pompë uji | Në pronësi/ ose me qera | **2** |
| **9.** | Vibrator | Në pronësi/ ose me qera | **2** |
| **10.** | Matrapik | Në pronësi/ ose me qera | **4** |
| **11.** | Motogjenerator | Në pronësi/ ose me qera | ***2*** |
| **12.** | Saldatrice | Në pronësi/ ose me qera | **4** |

a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
b. Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit për të tretë (e vlefshme).

a. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
b. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.
c. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në shtojcën në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
d. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara sipas shtojcës 10 nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, UKT sha.
e. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

3.9.Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për 3 muajt e fundit , jo më pak se 100 (njëqind) punonjës, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore të plotësuara rregullisht sipas formatit e përcaktimeve që kërkohet nga legjislacioni në fuqi , në të cilën të përfshihen:

- Minimuni 3 (tre) Inxhinier IT/elektronik/informatikë/telekomunikacion/informatikë elektronike/ inxhinieri informatike/teknologji informacioni.
- Minimumi 1 (nje) inxhinier elektroenergjitik/elektrik.
- Minimuni 1 (nje*)* Inxhinier Ndërtimi.
- Minimuni 1(një) specialist TIK shoqëruar me diplomen perkatese.
- Minimumi 1(nje)punonjes të çertifikuar në Menaxhimin e Projekteve Profesionale (Project Management Professional – P M P, PRINCE 2) lëshuar nga Project Management Institute (P M I) ose ekuivalente.
- Minimumi 1 (një) inxhinier/specialist të pajisur me çertifikatë Lead Auditor për "Sistemin e menaxhimit të Sigurisë së Informacionit".

- Minimumi 3 (tre) punonjes për instalimin/montimin te pajisjeve elektronike”
- Minimumi 6 (gjashte) punonjes teknik te paisjeve transmetuese.
- Minimumi 5 (pese) punonjes specialist/teknik i rrjetit kompjuterik.
- Operatori Ekonomik duhet të ketë në staf të pakten 4(kater) punonjës te certifikuar nga kompania prodhuese e sistemeve te kamerave e vertetuar me certifikaten perkatese .
- Operatori Ekonomik duhet të kete ne staf te pakten 4(kater) punonjes te certifikuar nga kompania prodhuese e sistemeve te alarmit .

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë listëpagesat për 3 ( tre) muajt e fundit, vërtetimin e punonjësve , diplomat përkatëse (per inxhinierat), çertifikatat përkatëse si dhe kontratat e punës (të vlefshme).

**3.10**.Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punesuar 1 (një) punonjës që të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", të shoqëruar me kontratë individuale të punës të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

**3.11.**Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit të pakten 21 (njëzetë e një) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te pakten:

- Grupi I- ( 10) punonjës nga të cilët 4( katër) të jenë karpentier, 4(katër) të jenë murator, 2 (dy) bojaxhi.
- Grupi II-6 (gjashtë ) nga të cilët 5 punonjës saldator si dhe 1(një) teknik ndërtimi.
- Grupi IV- 3(tre) punonjës të jenë elektriçist.
- Grupi V- 2(dy) punonjës të jenë elektriçist.

(Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmite perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme).

3.12. Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, për sistemet e kamerave (NVR,Kamera,programi i monitorimit,video ëall). Ne rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëebsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

3.13. Operatori ekonomik duhet te paraqesë nga kompania prodhuese e kamerave Çertifikate te standarteve nderkombetare te nivelit te V-te e cila te demonstroje nivelin me te larte te maturimit sigurise dhe organizimi te softëereve te procesit te punes se ofruar ose ekuivalente , IECQ dhe certifikate kriptografie nderkombetare Fips-140-2 ose ekuivalente.

3.14.Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

a)Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.
b)Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.
c)Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë OHSAS 18001-2007 / ose SSH 45001-2018**,** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.
d)Çertifikatën PASS 99:2012 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.
e) Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikaten ISO 27001:2013 (ose ekuivalente) mbi (Sistemin e menaxhimitë të sigurisë së informacionit), lëshuar nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë Certifikata kerkohet te jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.
Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

3.15. Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën ISO e prodhuesit të kamerave te vlefshme, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 (Quality assessment system for electronic components)

*Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike ISO duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë, sipas natyrës së punëve/shërbimeve apo mallrave që marrin përsipër.*

3.16. Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, per sistemin e alarmit dhe platformat e monitorimit te sistemeve te alarmit (softet) .Ne rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

3.17. Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik katalogjet teknike për produktet e sistemit të sigurisë (NVR,Kamera,Switch,Sisteme alarmi paneli,Platformen e monitorimit te kamerave,Platformen e monitorimit te sistemit te alarmit,Video wall).

**“Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”**

Specifikimet teknike te percaktuar per secilin produkt jane me parametra teknike minimale dhe konsiderohen si te nevojshem qe duhen te permbushen nga secili operator ekonomik per tu vleresuar oferte e rregullt.

Ofertat me parametrat teknike me te larte te produkteve jane te pranueshme.

Në rast se katalogjet teknike janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyera në gjuhën shqipe, dhe të noterizuara sipas legjislacionit në fuqi.

***<u>Shënim:</u>***

Kandidati, ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe, të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe t’i certifikojnë me vulën ”Apostille”.

Për operatorët ekonomik të huaj, që kanë regjistrim në shtetet anëtare të Konventës se Hagës (5 TETOR 1961), dokumentet e lëshuara duhet të përmbajnë vulën apostile në përputhje me ligjin nr. 9060, date 8.5.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë ne Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja".

Për operatorët ekonomikë të huaj, që kanë regjistrim në vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për “Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj”, duhet të bëhen legalizimet e ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.

Për operatorët ekonomik të huaj në përmbushje të kritereve të përcaktuara, nëse dokumentet e kërkuara ose ekuivalentet me to nuk ekzistojnë, sipas dispozitave të ligjit vendas të tij, atëherë duhet të paraqesin vetë deklarimet e tyre në përmbushje të secilit prej këtyre kritereve.

Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s’kualifikues.

Ne rast bashkimi operatoresh ekonomik te gjithe kriteret e mesiperme do te plotesohen nga secili anetar i BOE sipas puneve/sherbimeve/furnizimeve qe kane marre persiper sipas mareveshjesh se bashkepunimit .

**<u>Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.</u>**

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

**Shtojca 9**

[ *Shtojcë për t’u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

**KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj:

** Në respektim të nenit 23 të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.*

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 10**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor nëmarrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I**
**KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

**“Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”**

<table>
<tr><td colspan="3">Shërbim:<br>Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër</td></tr>
<tr><td>Kontrata Nr.</td><td>Titulli i Kontratës</td><td>Përshkrim i shkurtër i kontratës</td></tr>
<tr><td>01</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>02</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>03</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>…</td><td></td><td></td></tr>
</table>

**Shtojca 11**

( *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e  Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes sëprocesit të mini-konkursit*)

## SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Afatet e ekzekutimit:

**Shtojca 12**

( *Shtojcë për t’u plotëesuar nga Autoriteti Kontraktor)*

## TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

**“Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”**

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi  i kryerjes së shërbimeve:

**Shtojca 13**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

## NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
**< Emri >**

**Shtojca 14**

[*Shtojcë për t’u plotësuar Autoriteti Kontraktor*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data________]

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

**“Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët d oferta ekonomikisht më e favorshme d

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.___________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera ________________________________

*(me numra dhe fjalë)*

2.___________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera ____________________________

*(me numra dhe fjalë)*

Etj.______________________________

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1.___________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2.___________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

- * * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]*është identifikuar si oferta e suksesshme.

- Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____________ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

- Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

**“Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”**

- Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë ______________________________
- 
- Ankesa: ka ose jo______________
- (nëse ka) ka marrë përgjigje në datë ____________________________
- 

- **[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**Shtojca 15**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

*[Data]*

Për: *[Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]*

1. __________________________________________

**“Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”**

*2.* ________________________________________

*3.*________________________________________

* * *

Procedura e prokurimit: ______________________

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1.________________________________ ____________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera ____________________________

*(me numra dhe fjalë)*

2.________________________________ ____________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera ___________________________

*(me numra dhe fjalë)*

Etj.____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1.________________________________ ____________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2.________________________________ ____________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

____________________________________________________________________________

____________________________________________________________________________

____________________________________________________________________________

- * * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1.________________________________ ____________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _______________/ Pikët totale të marra ____
*(me numra dhe fjalë)*
2.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera ___________/Pikët totale të marra ____
*(me numra dhe fjalë)*
Etj.__

- Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]*, brenda ____________ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.
- Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë ______________________________
- Ankesa: ka ose jo______________
- (nëse ka) ka marrë përgjigje në datë ____________________________
- **[Titullari i autoritetit kontraktor]**
- **Shtojca 16**

**KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES**
**Shërbimet – Procedura e Hapur**

**Neni 1 Qëllimi**

- Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Shërbimeve të prokuruara me anë të procedurës së hapur.

- Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

- Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë,

citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

- KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

**Neni 2 Përkufizime**

- “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen sherbimin. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.
- “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojne detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

**Neni 3 Hartimi i Kontratës**

- Shpallja e fituesit do të sherbejë per hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

**Neni 4 Praktikat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit përProkurimin Publik.

- Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

- Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

**Neni 5 Informacioni Konfidencial**

- Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

- Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premton ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

**Neni 6 Prona Intelektuale**

- Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

- Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

- Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.

- Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje më ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t’i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

**Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit**

- Kontraktuesi duhet t’i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale te pranuara ne përgjithsi.

- Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.

- Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.

- Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashte kompetences së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

**Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit**

- Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.

- Kontraktuesi duhet t’i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha sherbimet, në sasitë e përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.

- Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

**Neni 9 Specifikime dhe Skicime**

- Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të pregatisi të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuara dhe të njohura në përgjithsi të pranueshme për Autoritetet Kontraktues dhe të marri parasysh standartet më të fundit.

- Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë pregatitur në bazë asnjanëse përsa i përket nxitjes së konkurencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

**Neni 10 Lejet dhe Liçensat**

- Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

**Neni 11 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor**

- Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në oferten e Kontraktuesit.

- Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.

- Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më te mira.

- Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkaku i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.

**Neni 12 Vendndodhja**

- Shërbimet duhet të kryhen në vendin ose vendet e specifikuara në kontratë.

- Në se nuk është specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të aprovojë vendin ose vendet e kryerjes së Shërbimeve, megjithatë, aprovimi nuk duhet të vonohet ne mënyrë të paarsyeshme.

**Neni 13 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

- Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithsi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

- Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithsi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

**Neni 14 Çmimi i Kontratës**

- Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në oferten e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

**Neni 15 Afatet e Pagesës**

- Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhen në kohë siç specifikohet në kontratë.

- Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes se Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.

- Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t’i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.

- Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita qe janë kryer Shërbimet, dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.

- Data e pagesës do të jëte dita që fondet debitohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

**Neni 16 Vonesa në Bërjen e Pagesës**

Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Kontraktor, megjithëse kontraktuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.

**Neni 17 Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve**

- Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës..

**Neni 18 Forca Madhore**

- Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontrates, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

- Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

- Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

**Neni 19 Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit**

- Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

- Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.

- Autoriteti Kontraktues mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t’i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

- Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.

- Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

**Neni 20 Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar**

- Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:
  - Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
  - Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates..
  - Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates...

**Neni 21 Negociatat dhe Amendamentet**

- Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.

- Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t’i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqsues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.

- Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqsues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

**Neni 22 Ndryshimi i Porosisë**

- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Shërbime shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

**Neni 23 Ndërprerja për Mosplotësim**

- Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
  - Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
  - Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

- Autoriteti Kontraktor duhet t’i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t’i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

**Neni 24 Ndërprerja për Shkak të Falimentimit**

- Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

- Autoriteti Kontraktor duhet t’i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

**Neni 25 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

- Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t’i shërbyer sa më mirë interesit publik.

- Autoriteti Kontraktor duhet t’i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

- Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t’i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

**Neni 26 Nënkontrata**

- Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrëveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë

- Kontraktori nuk duhet të nënkontraktojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësine e nënkontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

- Cdo nenkontraktor duhet të kete te drejte te marre pjese ne prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për shërbimet që do të furnizojë.

- Kur Kontraktuesi ka ndër mend të realizoje një pjesë të punimeve me nën-kontraktues, duhet të paraqesë në ofertë, sipas dokumentave të tenderit, gjithë dokumentacionin e kerkuar per nenkontraktuesin si dhe punimet konkrete qe do te jape me nensipermarrje.

- Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pamvarësisht nga sjellja e nenkontraktorit.

**Neni 27 Transferimi i të Drejtave**

- Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

**Neni 28 Sigurimi i Kontrates**

- Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e kërkuar.

- Shuma e sigurimit të kontrates duhet t’i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

- Sigurimi i kontrates do t’i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

**Neni 29 Baza Ligjore**

- Kontrata do të rregullohet nga dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

**Neni 30 Zgjidhja e Mosmarrveshjeve**

- Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

- Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 31 Përfaqësimi i Palëve**

- Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

- Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqsuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

- Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqsuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqsuesit.

**Neni 32 Lajmërimet**

- Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

- Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 33 Llogaritja e Afateve**

- Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

**Shtojca 17**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

## KUSHTET E VEÇANTA

### Shërbimet – Procedura e Hapur

Kushtet e veçanta të Kontratës hartohen në përputhje me objektin konkret të kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojne Kushtet e veçanta të kontratës.

**Neni 1 Përkufizime**

- Autoriteti Kontraktor është ________________________________

- Kontraktuesi është ____________________________________

**Neni 2 Sigurimi i kontratës**

- Sigurimi i kontratës në shumën prej *(10% të vlerës së ofertës)*________________________________________ duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

- Sigurimi i Kontratës do t’i lëshohet ose kthehet, menjehere Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm: ________________________________________________
  ________________________________________________________________
  ________________________________________________________________
  ________________________________________________________________

**Neni 3 Fillimi i Kontratës**

- Zbatimi i kontratës duhet të filloje më __________. Nëse nuk është specifikuar, zbatimi do të fillojë në datën që Kontraktuesi nënshkruan formularin e kontratës.

**Neni 4 Vendndodhja e Shërbimeve**

- Shërbimet do të kryhen në:

**Neni 5 Informacion që duhet dhënë nga Autoriteti Kontraktor**

- Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet t’i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme: ________________________
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________

**Neni 6 Kërkesat e Raportimit**

- Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm:
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________

**Neni 7 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

- Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojëAutoritetin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjësisë profesionale me shumë minimale si vijon:
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________

**Neni 8 Kushtet e Pagesës**

- Pagesa për Shërbimet duhet bërë sipas skedarit të mëposhtëm:
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________

- Çdo pagesë e skeduar duhet bërë brenda _________ ditëve nga data e arritjes së marrveshjes për pagesën ose nga data e marrjes së kërkesës me shkrim për pagesë cilado që të jetë më vonë. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

- Monedha e pagesës do të jetë ______. Nëse është lënë e paplotësuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

**Neni 9 Pagesa Paraprake**

- Përqindja e pagesës paraprake do të jetë _____. Nëse është lënë e paplotësuar, Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

- Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda ______ ditëve nga marrja e sigurimit te kontrates.

- Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t’i jepet Kontraktuesit sipas formulës së mëposhtme:_____________________________________________
_____________________________________________________________________

**Neni 10 Zbritja e garancisë së kontratës**

10.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë
_____________________________________________________________________
______________________________________________________________

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

**Shtojca 18**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I PUBLIKIMIT TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR**

- **<u>Autoriteti Kontraktor</u>**
-
- **I.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri _____________________________________________

Adresa _____________________________________________

Tel/Fax _____________________________________________

E-mail _____________________________________________

Adresa në Internet _____________________________________________

-

**I.2 Lloji i autoritetit kontraktor:**

| | |
|---|---|
| Institucion Qëndror | Institucion i Pavarur |
| **d** | **d** |
| Njesite e Qeverisjes Vendore | Tjetër |
| **d** | **d** |

**Seksioni 2**<u>**Objekti i Kontratës**</u>

**2.1 Numri i referencës së procedurës/lotit__________**

**2.2 Lloji i “Kontratave Publike për Shërbime”**

| Konkurs Projektimi | Shërbime Konsulence | Shërbime të tjera |
|---|---|---|
| **d** | **d** | **d** |

**2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuader**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Po | **d** | Jo | **d** |

**Nëse Po, lloji i Marreveshjes Kuadër**

**Me 1 Operator Ekonomik d**

**Me disa operatorë ekonomikë d**

**Të gjitha kushtet janë të përcaktuara**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Po | **d** | Jo | **d** |

**2.4 Përshkrim i shkurtër i kontratës**

1 Fondi limit _____________________________________________

2. Burimi i Financimit ______________________________________

3.Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër___________________________________________

**2. 5 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:**

Kohëzgjatja në **muaj ddd ose ditë dddd**

ose

duke filluar nga **dd/dd/dddd** me përfundim në **dd/dd/dddd**

**2.6 Ndarja në LOTE:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Po | **d** | Jo | **d** |

*Nëse Po,* numri i LOTEVE:**dd**

**2.7 Opsionet:**

Numri i rinovimeve të mundshme(nëse ka):**dd**

ose: nga**dd**në**dd**

**2.8 Kontrate me nenkontraktim:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Po | **d** | Jo | **d** |

**Seksioni 3Procedura**

**3.1 Lloji i procedurës:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| E hapur | | | |
| **d** | | | |

**3.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

A) **çmimi më i ulët**d

*ose*

B) **oferta ekonomikisht më e favorshme d**

lidhur me rëndësinë: Çmimi **dd pikë**

etj. **dd pikë**

**3.3 Numri i ofertave të dorëzuara:ddd**

**Numri i ofertave të rregullta:ddd**

**3.4. Gjatë procesit të prokurimit në fushen e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standartet e përgatitura nga Agjencia Kombetare e Shoqërise së Informacionit:**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Po | **d** | Jo | **d** |

**3.5. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standartet janë të paaplikueshme, është marrë miratimi paraprak nga Agjencia Kombetare e Shoqërisë së Informacionit**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Po | **d** | Jo | **d** |

**Seksioni 4** **<u>Informacion mbi kontratën</u>**

**4.1 Numri i Kontratës: _______________Data e Kontratës dd/dd/dddd**

- **4.2 Emri dhe adresa e kontraktorit**

Emri ____________________________________________
Adresa ____________________________________________
Tel/Fax ____________________________________________
E-mail ____________________________________________
Adresa e Internetit ____________________________________________

- 4.2.1**Emri dhe adresa e nenkontraktorit/eve**

Emri ____________________________________________
Adresa ____________________________________________
Tel/Fax ____________________________________________
E-mail ____________________________________________
Faqja e Internetit ____________________________________________

**4.3 Vlera totale përfundimtare e kontratës** *(duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktimin)*:

| | | | |
|---|---|---|---|
| Vlera | ________________ *(pa TVSH)* | Monedha | __________ |
| Vlera | ________________ *(me TVSH)* | Monedha | __________ |

**4.3.1** Vlera totale **e nenkontraktimit : ____**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Vlera | ________________ *(pa TVSH)* | Monedha | __________ |
| Vlera | ________________ *(me TVSH)* | Monedha | __________ |

**4.4 Informacione shtesë**

________________________________________________________________________________
____________________________________________________________________________

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi **dd/dd/dddd**

**Shtojca 19**

•

• [ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike]

•

• **1.Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri _______________________________________________

Adresa _______________________________________________

Tel/Fax _______________________________________________

E-mail _______________________________________________

Faqja në Internet _______________________________________________

**2. Lloji i procedurës: _______________________________________________**

**3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër_________________________**

**4. Numri i referencës së procedurës/lotit__________________________**

**5. Fondi limit  ______________________________________________**

**6. Vlera totale përfundimtare e kontratës** *(duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktimit)*:

| | | | |
|---|---|---|---|
| Vlera | ________________ *(me TVSH)* | Monedha | __________ |
| | | | |

Vlera  e nenkontraktimit______________*me Tvsh*Monedha

**7. Data e lidhjes së kontratës____________**

- **8. Emri dhe adresa e kontraktorit/ nenkontratorit**

Emri ____________________________________________

Adresa ____________________________________________

Nr. NIPT ____________________________________________

**Shtojca 20**

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]
[*Shtojcëpër t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS**

[Data ________

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*
Ne Emer te: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës ]*
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*
Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] t’i jetë akorduar kontrata,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimeve*] në një shumë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me [*emri i autoritetit kontraktor*]

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin e plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

**Shtojca 21**

## FORMULARI I ANKESËS PRANE AUTORITETIT KONTRAKTOR

***Ankesë drejtuar:*** ***Autoriteti Kontraktor***

### Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (psh, si individ, në partneritet, në bashkëpunim, në bashkim shoqërish).*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni) | | | | |
| Adresa | | | | |
| | | | | |

**“Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”**

| Qyteti | | Shteti | | Kodi Postar/Kodi Zip |
|---|---|---|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| Nr. Telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës) | | Nr. Faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës) |

| |
|---|
| Email |
| Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni) |

| | | |
|---|---|---|
| Firma e zyrtarit të autorizuar | | Data (viti/muaji/dita) |
| Nr. Telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës) | | Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës) |

**Seksioni II. Informacion për Procedurën**

1. **Numër Identifikimi**
   *Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentat e tenderit, duke përfshirë* ***llojin e procedurës së përdorur*** *për prokurimin në fjalë (psh, Kërkesë për Propozime(KP), Procedurë e Hapur(PH), Procedurë e Kufizuar(PK), Procedurë me Negociim(PN), Shërbim Konsulence (SHK), Konkurs Projektimi (KP).*

| |
|---|
| |

2. **Autoriteti Kontraktor**
   *Emri i autoritetit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

| |
|---|
| |

3. **Vlera e Përllogaritur e Prokurimit**
   *Llogaritja e vlerës së kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë)*

| |
|---|
| |

**4. Objekti i Kontratës**

*Përshkrim i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve që blihen.*

**5. Afati Përfundimtar për Dorëzimin e Ofertës**

*Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.*

Data (viti/muaji/dita)

**6. Data e Përcaktimit të Kontratës Fituese**

Data (viti/muaji/dita) nëse zbatohet

**Seksioni III. Përshkrimi i ankesës**

**1. Baza Ligjore e Ankesës**

(shkruani shkeljen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumenta, etj)

**2. Deklaratë e Hollësishme e Fakteve dhe Argumenteve**

*Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet perkatëse të dokumentave të tenderit, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.*

**3. Lista e Shtojcave**

*Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë. Bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht* ***çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e tenderit, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj .*** *Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për prokurimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë **autoritetit kontraktor**

Shënim: Për ankesat pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet t’i referoheni Formularit të Ankesës se nxjerrë nga ky institucion.

**Nr. Faks:**
**E-mail:**

**Nenshkrimi dhe Vula e ankuesit**

**Shtojca 22**

**DRAFTI I MARRËVESHJES KUADËR**
( KU TE GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA)
**PER PUNË / MALLRA / SHËRBIME**

[Përdorimi i ketij draft marrëveshje është detyruese për të gjitha Autoritetet Kontraktore që do të përdorin marrëveshjen kuadër)

**Nr __**

**DATA:**

Kjo kontratë lidhet [*data*], midis [*emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor*] tani e tutje të referuar

**“Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”**

si “Autoriteti Kontraktor” dhe [*emri dhe adresa e Kontraktuesit*] të përfaqësuar nga [*përfaqësuesi*], tani e tutje i quajtur si “Kontraktuesi”.

Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë [*data*] bie dakord të furnizoje mallrat, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë kontrate
- Formulari i Deklarimit te Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi
- Specifikimet Teknike
- Formulari i çmimit të ofertës

- Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj kontrate.

**Neni 1 Objekti**

1.1 Objekti i marreveshjes kuadër është të përcaktojë kushtet, përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat për dorëzimin e mallrave/sherbimeve/puneve në vijim.

[përshkrimi i përgjithshëm]

1.2 Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatorët ekonomikë, palë në marrëveshje.P.sh. kurdoherë që Autoriteti Kontraktor i përfshirë në këtë marreveshje, do të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate, duhet që të dërgojë “ftesën për ofertë” tek kontraktuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e parashikuara, janë vetëm sasi orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t’i blerë ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato te parashikuara.

1.4 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do t’i lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktor vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të specifikuara dhe/ose në rast se autoriteti kontraktor vendos të mos blejë asnjënga këto sasi për disa artikuj.

1.5 **Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër**

______________________

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimet për njësi për punë/mallra /shërbime janë treguar në Formularin e Cmimit të Ofertës.

2.2 Çmimet e njësive duhet të jenë fikse dhe nuk duhet t’i nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura në këtë marrëveshje kuadër.

**Nënshkrimet dhe Datat**

| **Për Kontraktuesin** | **Për Autoritetin Kontraktues** |
| --- | --- |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri:** | | **Emri:** | |
| Pozita: | | Pozita: | |
| Nënshkrimi: | | Nënshkrimi: | |
| Data: | | Data: | |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

**Shtojca 23**

## DRAFTI I MARRËVESHJES KUADËR

## ( KU JO TË GJITHA  KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA)
## PËR PUNË / MALLRA / SHËRBIME

**Emri i Autoritetit Kontraktor,**

Dhe

**Emri i Kontraktuesit**

Bien dakord si vijon:

**“Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”**

**Të nënshkruajnë këtë marrëveshje kuadër për objektin:** < vendosni titullin >me numrin identifikues : <*vendosni Numrin e Prokurimit*>

**Neni 1 Objekti**

• Objekti i kësaj marreveshje kuadër është të vendosë rregullat për kontratat të cilat do të lidhen përmes procesit të mini-konkursit vetëm ndërmjet operatorëve ekonomike që janë palë e kësaj marrëveshje kuadër.

• Kjo marrëveshje kuadër nuk është një kontratë në vete por përcakton kushtet për kontratat që do të lidhen në bazë të saj.

• Kontraktuesi është vetëm një nga palët e marrëveshjes kuadër.

**Neni 2 Detyrimet e Palëve**

2.1 Autoriteti Kontraktues, palë në këtë marrëveshje, do t'i dërgojë kontraktuesit “Ftesën për Ofertë” kurdo që paraqitet nevoja për punë/mallra/shërbime.

• Kontraktuesi, detyrohet të dorëzojë një ofertë kurdo që kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 3 Kontratat në zbatim të marrëveshjes kuadër**

3.1 Kontratat do të nenshkruhen vetëm pas procesit të mini-konkursit.

**Neni 4 Procesi i mini-konkurrencës**

4.1 Procesi i mini- konkursit do të kryhet me të gjithe operatorët ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër, kurdoherë që paraqitet nevoja për punë/mallra/shërbime për Autoritetet Kontraktore.

• Autoriteti Kontraktor do të ri-hapë konkursin në bazë të kushteve të njëjta ose të kushteve të tjera të vendosura në ftesën për ofertë, sipas përcaktimeve në dokumentat e tenderit.

4.3 Kurdoherë që paraqitet nevoja për punë/mall/shërbim Autoriteti Kontraktor duhet të përgatisë Ftesat për Oferte dhe t'ua dërgojë të gjithë operatorëve ekonomike, palë në marrëveshjen kuadër. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas kritereve të përcaktuara në Ftesën për Ofertë.

**Neni 5 Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër**

**Nënshkrimet dhe datat**

| **Për Kontraktuesin** | | **Për Autoritetin Kontraktues** | |
|---|---|---|---|
| **Emri :** | | **Emri:** | |
| Pozita: | | Pozita: | |
| Nënshkrimi: | | Nënshkrimi: | |
| Data: | | Data: | |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

**Shtojca 24**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE ANULIMIT**

**1.Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri ______________________________________________

Adresa ______________________________________________

Tel/Fax ______________________________________________

E-mail ______________________________________________

Faqja në Internet ______________________________________________

**“Shërbime të integruara dhe furnizim vendosje të pajisjeve elektronike”**

1. **Lloji i procedurës:** ________________________________________
2. **Numri i Referencës:** _______________________________________
3. **Objekti i kontratës** _________________________________________
4. **Fondi limit** ______________________________________________
5. **Arsyet e Anulimit:**

Bazuar në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 24, pika 1: **a)** ;

**b)** ;

**c)** ;

**ç)** ;

**d)** ;

**dh)** ;

**Etj.** ________________________________________

**6. Informacione shtesë**

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi